

**UDHËZIM**  
**Nr. 16, datë 12.6.2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 28, DATË 12.12.2019, “PËR  
ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË MATURËS  
SHTETËRORE 2020”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 51, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Në pikën 8, të udhëzimit nr. 28, datë 12.12.2019, togfjalëshi “... dhe zgjasin 2 orë.” zëvendësohet me togfjalëshin “... dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore arsimore dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
**Besa Shahini**